

Shabllon i Planeve të Thjeshtëzuara të Veprimit për Energji nga Burimet e Ripërtëritshme për Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë (SREAP)

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|----|
| 1. Përmbledhje e politikave kombëtare për energji të ripërtëritshme..... | 3 |
| 2. Konsumi i pritur fundor i energjisë 2010-2020..... | 3 |
| 3. Caqet indikative të energjisë së ripërtëritshme..... | 6 |
| 3.1. Caqet indikative sektoriale..... | 6 |
| 4. Masat për arritjen e caqeve indikative..... | 10 |
| 4.1. Pasqyrë e të gjitha politikave dhe masave për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme..... | 10 |
| 4.2. Masat specifike për plotësimin e kushteve të parashtruara me nenet 13, 14, 16 dhe 17-21 të Direktivës 2009/28/EC..... | 11 |
| 4.2.1. Dispozitat informative (nenet 14(1), 14(2) dhe 14(4) të Direktivës 2009/28/EC).. | 11 |
| 4.2.2. Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë elektrike (nenet 16(1) dhe 16(3-6) të Direktivës 2009/28/EC)..... | 12 |
| 4.2.3. Operimi i rrjetit elektroenergetik (neni 16(2) dhe neni 16(7-8) i Direktivës 2009/28/EC..... | 12 |
| 4.3. Skemat përkrahëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme që aplikohen nga palët kontraktuese apo një grup i palëve kontraktuese në energji elektrike..... | 13 |
| 4.4. Skemat përkrahëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme që aplikohen nga palët kontraktuese apo një grup i palëve kontraktuese në energji ngrohje dhe ftohje..... | 15 |
| 4.5. Skemat përkrahëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme që aplikohen nga palët kontraktuese apo një grup i palëve kontraktuese në transport..... | 15 |
| 4.6. Masat specifike për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga biomasa..... | 16 |
| 4.6.1. Furnizimi me biomasë: në vend dhe përmes tregtimit..... | 16 |
| 4.6.2. Masat për shtimin e disponueshmërisë së biomasës, duke marrë parasysh përdorimet tjera të saj (bujqësi dhe pylltari)..... | 19 |
| 5. Vlerësimet..... | 20 |
| 5.1. Vlerësimet e potencialit në dispozicion për zhvillimin e burimeve vendore të energjisë së ripërtëritshme..... | 20 |

Rekomandimet e Këshillit Ministror Nr. 2010/01/MC-EnC mbi promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme që rregullohet me dispozitat relevante të Direktivës 2009/28/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 23 prill 2009 e që duhet të implementohet brenda afateve të caktuara. Ajo gjithashtu i referohet shfrytëzimit të disa tabelave dhe pyetjeve nga Shablloni i Planeve Kombëtare të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme që është miratuar me Vendimin e Komisionit C(2009) 5174 e datës 30 qershor 2009, që shfrytëzohen si udhërrëfyes në procesin e vlerësimit dhe përmbledhjes së të gjeturave kryesore.

Task Forca për Energji të Ripërtëritshme ka propozuar thjeshtësimin e shabllonit që të obligueshëm për shtetet anëtare të BE-së dhe e ka bërë atë më të përshtatshëm për raportim sa i përket kushteve të rekomandimeve. Ky është versioni i thjeshtësuar i shabllonit për palët kontraktuese dhe shfrytëzimi i këtij shablloni rekomandohet për tu siguruar se SREAP-të janë complete, mbulojnë elementet e adresuara në rekomandime dhe janë të krahasueshme me njëra tjetrën.

Gjatë plotësimit të shabllonit, nga palët kontraktuese kërkohet që t'i përmbahen definicioneve, rregullave të kalkulimit dhe terminologjisë përkatëse të Direktivës 2009/28/EC. Më tej, palët kontraktuese inkurajohen që të shfrytëzojnë definicionet, rregullat e kalkulimit dhe terminologjinë e shfrytëzuar në Rregulloren (EC) Nr. 1099/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit¹.

Për faktin se aktualisht është duke u diskutuar marrëveshja mbi caqet obligative të BRE-ve për vitin 2020, propozohet që caqet indikative të shfrytëzohen duke u bazuar në metodologjinë e shfrytëzuar për kalkulimin e caqeve të shteteve anëtare të BE-së, sipas Direktivës 2009/28/EC. Kjo metodologji paraqet një ngritje në krahasim me vitin 2005, me 5.5% plus norma e ndryshueshme varësisht nga GDP. Në krahasim me normat e vitit 2005, rritjet janë të kalkuluara dhe janë përmbledhur në faqen 2 të "Studimit mbi implementimin e Direktivës së re të BE-së mbi energjinë e përsëritshme në Komunitetin e Energjisë"². Këtë studim mund ta gjeni në adresën: <http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/644177.PDF>

Më shumë informata mund të ofrohen ose në strukturën e përshkruar të planeve të veprimit ose në anekset përkatëse të tyre.

Shablloni aktual përfshin vetëm kërkesat mbi raportimin të cilat duhet të plotësohen deri më 30 qershor 2011. Elementet tjera që janë kërkuar në rekomandime kanë afate më të gjata. Në kohë të duhur do të sigurohen edhe shabllone tjera që trajtojnë këto elemente.

Pasuset me shkronja kursive kanë për qëllim që t'i udhëzojnë palët kontraktuese në përgatitjen e SREAP-ve përkatës. Palët kontraktuese mund t'i fshijnë këto pasuse në versionin e SREAP-it të cilin do t'ia dorëzojnë Sekretariatit.

¹ OJL 304, 14.11.2008, f.1

² 2010, realizuar nga një konsorcium i udhëhequr nga IPA Energy dhe Water Economics (MB) dhe EUP-NTUA (Greqi)

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KOMBËTARE TË ENERGISË SË RIPËRTËRITSHME TË PALËVE KONTRAKTUESE

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

Ju lutemi të jepni një pasqyrë të shkurtër të politikës kombëtare për energjinë e ripërtëritshme, në të cilën do të përshkruani caqet e asaj politike (siç janë siguria e furnizimit, përfitimet mjedisore, ekonomike dhe sociale) dhe veprimet kryesore strategjike.

2. KONSUMI I PRITUR FUNDOR I ENERGISË 2010-2020

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

Në këtë kaptinë, nga palët kontraktuese kërkohet që të japin parashikimet e tyre sa i përket konsumit fundor bruto të energjisë së të gjitha llojeve (edhe nga burimet e ripërtëritshme edhe nga ato konvencionale), në mënyrë të përgjithësuar dhe për sektor, deri në vitin 2020.

Këto parashikime duhet gjithashtu të marrin parasysh efektet e pritura të masave të efijencës dhe kursimit të energjisë të cilat duhet të zbatohen gjatë kësaj periudhe. Nën titullin “skenari referent” duhet të paraqitet një skenar që merr parasysh vetëm masat e efijencës dhe kursimit të energjisë që janë miratuar para vitit 2009. Nën titullin “skenari me efijencë të shtuar të energjisë” duhet të paraqitet një skenar që merr parasysh të gjitha masat e miratuara nga viti 2009 e tutje. Elaborimi i pjesëve tjera të SREAP-së bazohet në këtë skenar me efijencë të shtuar të energjisë.

Termi “konsum për ngrohje dhe ftohje” nënkuptohet si ngrohje e prodhuar (ngrohje e shitur), plus konsumi final i të gjitha mallrave tjera energjetike përveç energjisë elektrike, në sektorët e konsumit fundor si në industri, amvisëri, shërbime, bujqësi, pylltari dhe kultivim peshku. Rrjedhimisht, nocioni ngrohje dhe ftohje mbulon edhe konsumin fundor të energjisë për qëllime përpunimi. Energjia elektrike gjithashtu mund të shfrytëzohet për ngrohje dhe ftohje në konsum fundor, por kjo energji elektrike mbulohet me cakun indikativ për energjinë elektrike dhe për këtë arsye nuk është përfshirë këtu.

Sipas nenit 5(6) të Direktivës 2009/28/EC, me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me cakun indikativ të vitit 2020 dhe me trajektoren e ndërmjetme, sasia e energjisë së konsumuar në aviacion duhet të mos mbulojë mbi 6,18% të konsumit final të energjisë bruto nga pala kontraktuese. Përshtatjet përkatëse (nëse ka nevojë) duhet të bëhen brenda tabelës. Në kutinë në vijim tregohet se si të kalohet kjo

Kutia – si të kalkulohet ‘mekanizmi limitues për aviacion’ i Direktivës për Energji të Ripërtërishme

Të supozojmë se shteti A nga sasia e gjithmbarshme bruto e energjisë së konsumuar (GFEC) shpenzon X në konsum të energjisë nga aviacioni (AEC):

$$X = AEC/GFEC$$

Le të supozojmë se $X > 6,18\%$

Në këtë rast limiti tregon se për qëllime të vlerësimit të pajtueshmërisë

$$GFEC \text{ e përshtatur} = GFEC - AEC + AEC \text{ e përshtatur}$$

$$\text{ku } AEC \text{ e përshtatur} = 0,0618 * GFEC$$

Me fjalë tjera

$$GFEC \text{ e përshtatur} = GFEC - AEC + 0,0618 * GFEC =$$

$$= GFEC - X * GFEC + 0,0618 * GFEC =$$

$$= GFEC * (1,0618 - X)$$

“përshtatja” si % e GFEC reale dhe si funksion i X është

$$\text{Përshtatja} = (GFEC - GFEC \text{ e përshtatur})/GFEC =$$

$$= X - 0,0618$$

Tabela 1: Konsumi final bruto i pritur i energjisë i [palës kontraktuese] për ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport deri në vitin 2020, duke marrë parasysh efektet e masave të efijencës së energjisë dhe kursimit të energjisë³ 2010 - 2020 (ktoe)

| | 2005 | 2010 | | 2011 | | 2012 | | 2013 | | 2014 | |
|---|------------|------------------|-----------------------------|------------------|-----------------------------|------------------|-----------------------------|------------------|-----------------------------|------------------|-----------------------------|
| | Viti bazik | skenari referent | efijenca energjetike shtesë | skenari referent | efijenca energjetike shtesë | skenari referent | efijenca energjetike shtesë | skenari referent | efijenca energjetike shtesë | skenari referent | efijenca energjetike shtesë |
| 1) ngrohje dhe ftohje ⁴ | | | | | | | | | | | |
| 2) energjia elektrike ⁵ | | | | | | | | | | | |
| 3) transporti sipas nenit 3(4)a ⁶ | | | | | | | | | | | |
| 4) konsumi fundor i energjisë bruto ⁷ | | | | | | | | | | | |
| <i>Kalkulimi në vijim është i nevojshëm vetëm nëse konsumi final për aviacion pritet të jetë më i lartë se sa 6.18%</i> | | | | | | | | | | | |
| Konsumi final në aviacion | | | | | | | | | | | |
| Zvogëlimi i limitit për aviacion Neni 5(6) ⁸ | | | | | | | | | | | |
| Konsumi total pas zvogëlimit për aviacion | | | | | | | | | | | |

³ Këto parashikime të efijencës së energjisë dhe kursimit të energjisë duhet të jenë në konsistencë me parashikimet tjera të ngjashme të palëve të kontraktuese të cilat ato i kanë vendosur në planet e veprimit sipas Direktivës mbi Shërbimet Energjetike dhe Direktivës mbi Performansën Energjetike të Ndërtesave. Nëse në ato plane të veprimit janë vendosur njësi tjera, atëherë duhet të tregohet se cilët faktorë janë përdorur.

⁴ Është konsumi final i energjisë nga të gjitha burimet përveç energjisë elektrike, për qëllime tjera nga transporti, plus konsumi i ngrohjes për shfrytëzim vetanak në centrale të prodhimit të energjisë elektrike dhe në ngrohtore dhe humbjet e ngrohjes në rrjet (pikat '2 Shfrytëzimi vetanak në impiant' dhe '11 Humbjet në bartje dhe shpërndarje' në faqet 23 dhe 24 të Rregullores mbi Statistikat Energjetike, OJ L304 të datës 14.11.2008).

⁵ Konsumi bruto i energjisë elektrike është prodhimi nacional bruto i energjisë elektrike, përfshirë vetëprodhimin, plus importet, minus eksportet.

⁶ Konsumi në transport, siç përkufizohet në nenin 3(4)a të Direktivës 2009/28/EC. Energjia elektrike e ripërtëritshme në transport rrugor, në këtë shifër, duhet të shumëzohet me faktor prej 2,5 siç parashihet me nenin 3(4)a të Direktivës 2009/28/EC.

⁷ Siç përkufizohet në nenin 2.f të Direktivës 2009/28/EC. Këtu përfshihet konsumi final i energjisë, plus humbjet në rrjet dhe përdorimi vetanak i ngrohjes dhe energjisë elektrike në termocentrale dhe ngrohtore (NB: këtu nuk përfshihet konsumi i energjisë elektrike për depozitim të ujit me pompa apo për transformim në bojlerë elektrikë apo pompa të ngrohjes në ngrohtore qendrore).

⁸ Sipas nenit 5(6) konsumi për aviacion duhet të konsiderohet se mbulon vetëm deri në 6.18% nga konsumi final bruto i energjisë.

| | 2015 | 2016 | | 2017 | | 2018 | | 2019 | | 2020 | |
|--|------------|------------------|------------------------------|------------------|------------------------------|------------------|------------------------------|------------------|------------------------------|------------------|------------------------------|
| | Viti bazik | skenari referent | efiçienca energjetike shtesë | skenari referent | efiçienca energjetike shtesë | skenari referent | efiçienca energjetike shtesë | skenari referent | efiçienca energjetike shtesë | skenari referent | efiçienca energjetike shtesë |
| 1) ngrohje dhe ftohje ⁹ | | | | | | | | | | | |
| 2) energjia elektrike ¹⁰ | | | | | | | | | | | |
| 3) transporti sipas nenit 3(4)a ¹¹ | | | | | | | | | | | |
| 4) konsumi fundor i energjisë bruto ¹² | | | | | | | | | | | |
| <i>Kalkulimi në vijim është i nevojshëm vetëm nëse konsumi final për aviacion pritet të jetë më i lartë se sa 6.18%¹³</i> | | | | | | | | | | | |
| Konsumi final në aviacion | | | | | | | | | | | |
| Zvogëlimi i limitit për aviacion Neni 5(6) | | | | | | | | | | | |
| Total konsum pas zvogëlimit për aviacion | | | | | | | | | | | |

⁹ Shih fusnotën 4.

¹⁰ Shih fusnotën 5.

¹¹ Shih fusnotën 6.

¹² Shih fusnotën 7.

¹³ Shih fusnotën 8.

3. CAQET INDIKATIVE TË ENERGJISË SË RIPËRTËRITSHME

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

3.1. Caqet indikative sektoriale

Sipas nenit 4(1) të Direktivës 2009/28/EC, nga palët kontraktuese kërkohet që të përcaktojnë caqet e tyre indikative sa i përket pjesës së energjisë që do prodhohet nga burimet e ripërtëritshme deri në vitin 2020, në sektorët e mëposhtëm:

- ngrohje dhe ftohje;
- energjisë elektrike;
- transport.

Shuma e tri caqeve indikative sektoriale, të shprehura në vëllime të pritura (ktoe) duhet të jetë së paku e barabartë me sasinë e energjisë nga burimet e ripërtëritshme që korrespondon me caqet indikative të palës kontraktuese për vitin 2020 (siç raportohet në qelizën e fundit të tabelës 2).

Përveç kësaj, caku indikativ i transportit duhet të jetë në pajtueshmëri me kushtet e nenit 3(4) të Direktivës 2009/28/EC që kërkon që 10% të energjisë në transport të prodhohet nga burimet e ripërtëritshme. Megjithatë duhet të theksohet se kalkulimi i pajtueshmërisë me cakun indikativ të nenit 3(4) dallon nga kalkulimi i kontributit të transportit në cakun e përgjithshëm kombëtar të palës kontraktuese sa i përket energjisë së ripërtëritshme.

Për cakun indikativ të transportit, dhe jo për cakun e përgjithshëm indikativ:

- mes derivateve të naftës, si emërues mund të numërohen vetëm benzina dhe dizeli. Kjo do të thotë se kerozina/derivatet e aeroplanëve që përdoren në aviacion dhe derivatet që shfrytëzohen në transport detar nuk numërohen (edhe pse dizeli shfrytëzohet nga disa trena dhe disa anije që përdoren në rrugë ujore të brendshme);
- Biokarburantët nga mbeturinat, mbetjet, materialet celuloze joushqimore dhe materialet ligno-celuloze numërohen dyfish kundrejt numëruesit;
- Energjia elektrike nga burimet e ripërtëritshme që përdoret në vetura rrugore numërohet 2.5 herë kundrejt emëruesit dhe numëruesit.

Sipas nenit 3(4)(c) të Direktivës 2009/28/EC, për të kalkuluar kontributin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme dhe të konsumuar nga veturat elektrike, palët kontraktuese mund të zgjedhin nëse do të shfrytëzojnë mesataren e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme në Komunitet apo mesataren e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në vendin e tyre, në pajtim me matjet e bëra dy vite para vitit në fjalë. Lidhur me parashikimet e mesatares së energjisë nga burimet e ripërtëritshme në Komunitet, palët kontraktuese mund të shfrytëzojnë skenarët për të ardhmen që përgatitur nga Komuniteti për Energji¹⁴.

¹⁴ "Studimi mbi implementimin e Direktivës së Re të BE-së në Komunitetin e Energjisë", 2010, IPA, EPU-NTUA: <http://www.energy-community.org/pls/portal/docs/644177.pdf>

Në tabelën 3 nga palët kontraktuese kërkohet që t'i japin informatat të cilave u referohet më sipër. Gjatë plotësimit të tabelës, palët kontraktuese duhet të shfrytëzojnë të dhënat më të detajuara mbi shfrytëzimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme të cilat kërkohen në tabelën 9. Kalkulimet në tabelat 4a dhe 4b ofrojnë udhëzime mbi përgatitjen e tabelës 3.

Tabela 3: Caku indikativ për vitin 2020 dhe trajektorja e paraparë e energjisë nga burimet e ripërtëritshme në ftohje dhe ngrohje, energji elektrike dhe transport (tabelat e kalkulimit 4a dhe 4b ofrojnë udhëzime mbi përgatitjen e tabelës 3).

| | 2005 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| RES-H&C (%) ¹⁵ | | | | | | | | | | | | |
| RES-E (%) ¹⁶ | | | | | | | | | | | | |
| RES-T (%) ¹⁷ | | | | | | | | | | | | |
| Pjesa e gjithmbarshme e RES (%) ¹⁸ | | | | | | | | | | | | |

¹⁵ Pjesa e energjisë së ripërtëritshme në ngrohje dhe ftohje: konsumi final bruto i energjisë nga burimet e ripërtëritshme për ngrohje dhe ftohje (siç definohet në nenet 5(1)b) dhe 5(4) të Direktivës 2009/28/EC, pjesëtuar me konsumin final bruto të energjisë për ngrohje dhe ftohje. Vija (A) nga tabela 4a pjesëtuar me vijën (1) të tabelës 1.

¹⁶ Pjesa e energjisë së ripërtëritshme elektrike: konsumi final bruto i energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë elektrike (siç definohet në nenet 5(1)a) dhe 5(3) të Direktivës 2009/28/EC pjesëtuar me konsumin final bruto të energjisë elektrike. Rreshti (B) nga tabela 4a pjesëtuar me rreshtin (2) të tabelës 1.

¹⁷ Pjesa e energjisë së ripërtëritshme në transport: konsumi final i energjisë së ripërtëritshme në transport (siç definohet në nenet 5(1)c) dhe 5(5) të Direktivës 2009/28/EC pjesëtuar me konsumin në transport të 1)benzinës, 2) dizelit, 3) bioderivateve të shfrytëzuara në transportin rrugor dhe hekurudhor dhe 4) energjinë elektrike në transportin rrugor (siç paraqitet në rreshtin 3 të tabelës 1). Vija (J) nga tabela 4b pjesëtuar me rreshtin (3) të tabelës 1.

¹⁸ Pjesa e energjisë së ripërtëritshme në konsumin final bruto të energjisë. Rreshti (G) nga tabela 4a pjesëtuar me rreshtin (4) nga tabela 1.

Tabela 4a: Tabela kalkuluese e kontributit të energjisë së ripërtëritshme nga secili sektor në konsumin final të energjisë (ktoe)

| | 2005 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|--|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| (A) konsumi i pritur bruto i BRE për ngrohje dhe ftohje | | | | | | | | | | | | |
| (B) konsumi i pritur bruto i energjisë elektrike nga BRE | | | | | | | | | | | | |
| (C) konsumi i pritur i energjisë nga BRE në transport | | | | | | | | | | | | |
| (D) konsumi total i pritur i BRE ¹⁹ | | | | | | | | | | | | |

¹⁹ Në bazë të nenit 5(1) të Direktivës 2009/28/EC gazi, energjia elektrike dhe hidrogjeni nga burimet e ripërtëritshme të energjisë mund të konsiderohen vetëm një herë. Nuk lejohet numërim i dyfishtë.

Tabela 4b: Tabela kalkuluese për energjinë e ripërtëritshme në transport (ktoe)

| | 2005 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|--|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| (A) konsumi i pritur i BRE në transport ²⁰ | | | | | | | | | | | | |
| (B) konsumi i pritur i energjisë elektrike nga BRE në transport ²¹ | | | | | | | | | | | | |
| (C) konsumi i pritur i bioderivateve nga mbeturinat, celulozat joushqimore dhe materialet lingoceluloze në transport ²² | | | | | | | | | | | | |
| (D) kontributi i pritur i RES në transport RES-T pjesa: (C)+(2,5-1)x(H)+(2-1)x(I) | | | | | | | | | | | | |

²⁰ Përfshirë të gjitha BRE-të e përdorura në transport, përfshirë energjinë elektrike, hidrogjenin dhe gazin nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, dhe duke mos përfshirë bioderivatet që nuk janë në pajtueshmëri me kriteret e qëndrueshmërisë (siç përcaktohet me nenin 5(1), nënparagrafi i fundit). Këtu duhet të specifikohen vlerat pa shfrytëzuar faktorët shumëzues.

²¹ Këtu duhet të specifikohen vlerat pa shfrytëzuar faktorët shumëzues.

²² Këtu duhet të specifikohen vlerat pa shfrytëzuar faktorët shumëzues.

4. MASAT PËR ARRITJEN E CAQEVE INDIKATIVE

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

4.1. Pasqyrë e të gjitha politikave dhe masave për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme

Tabela 5: Pasqyrë e politikave dhe masave

| Emri dhe referenca e masës | Lloji i masës* | Rezultati i pritur** | Grupi apo aktiviteti synuar*** | Ekzistuese apo e planifikuar | Datat e fillimit dhe përfundimit të masës |
|----------------------------|----------------|----------------------|--------------------------------|------------------------------|---|
| 1. | | | | | |
| 2. | | | | | |
| 3. | | | | | |
| ... | | | | | |
| | | | | | |

* Tregoni nëse masa është (kryesisht) rregullative, financiare apo e butë (p.sh. fushatë informative).

**A është rezultati i pritur ndryshim në mënyrë të sjelljes, në kapacitete të instaluar (MW;t/vit), energji të prodhuar (ktoe)?

***Cilët janë personat e synuar: investuesit, shfrytëzuesit fundorë, administrata publike, planifikuesit, arkitektët, instaluesit, etj? apo cili është aktiviteti/ sektori i synuar: prodhimi i bioderivateve, shfrytëzimi energjetik i plehrave, etj.)?

4.2. Masat specifike për plotësimin e kushteve të parashtruara me nenet 13, 14, 16 dhe 17-21 të Direktivës 2009/28/EC

4.2.1. Dispozitat informative (nenet 14(1) dhe 14(6) të Direktivës 2009/28/EC)

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

Këtu duhet përshkruar fushatat aktuale dhe të ardhme informative dhe vetëdijësuese dhe programet gjegjëse dhe rishikimet e planifikuara të tyre përkrah rezultateve të pritura të tyre. Palët kontraktuese duhet gjithashtu të tregojnë se cili autoritet përkatës do të monitorojë dhe shqyrtojë efektet e programeve. Kur autoritetet regjionale apo lokale kanë rol të rëndësishëm, ju lutemi ta theksoni dhe ta përmbledhni atë.

(a) Referenca ndaj legjislacionit ekzistues nacional apo rajonal (nëse ka të tillë) lidhur me kushtet e informimit, sipas nenit 14 të Direktivës 2009/28/EC.

(b) Organi (organet) përgjegjës(e) për shpërndarjen e informatave në nivel lokal/rajonal/shtetëror.

(c) Përmbledhje e masave ekzistuese dhe të planifikuara në nivel rajonal/lokal (kurdo që kjo është relevante):

(d) Ju lutemi të tregoni se si vëhen në dispozicion informatat mbi masat përkrahëse për shfrytëzimin e energjisë së ripërtëritshme në energji elektrike, ngrohje dhe ftohje dhe transport për të gjithë aktorët relevantë (konsumatorët, ndërtuesit, instaluesit, arkitektët, furnizuesit e pajisjeve dhe veturave relevante). Kush është përgjegjës për sajimin dhe publikimin e këtyre informatave? A ka resurse specifike të informatave për grupe të ndryshme individësh, siç janë konsumatorët, ndërtuesit, menaxhuesit e pronave, agjentët e pronave, instaluesit, arkitektët, fermerët, furnizuesit e pajisjeve që shfrytëzojnë burie të ripërtëritshme të energjisë, administratën publike? A ka fushata informative apo qendra të përhershme informative aktualisht apo a janë planifikuar qendra apo fushata të tilla?

(e) Ju lutemi të përshkruani fushatat dhe programet ekzistuese dhe ato të planifikuara për informim, vetëdijësim apo trajnim të qytetarëve mbi përfitimet dhe praktikabilitetin e zhvillimit dhe përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme. Cili është roli i aktorëve regionalë dhe lokalë në dizajnimin dhe menaxhimin e këtyre programeve?

4.2.2. Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë elektrike (neni 16(3), neni 16(5) dhe neni 16(7) i Direktivës 2009/28/EC)

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

Përveç situatës aktuale dhe legjislacionit ekzistues, duhet të përshkruhen edhe veprimet në të ardhmen, ndryshimet e planifikuara, trupat përgjegjëse për to dhe rezultat e pritura.

(a) Referencë ndaj legjislacionit ekzistues nacional sa i përket rrjeteve të energjisë (neni 16)

(b) A ka rregulla mbi ndarjen e shpenzimeve për adaptimet teknike të rrjetit që kryhen nga operatorët e sistemit të bartjes dhe shpërndarjes? Nëse po, ku? Si sigurohet se këto rregulla bazohen në kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese? A ka

rregulla speciale për prodhues që veprojnë në rajone periferike apo rajone me popullatë më pak të dendur? (rregullat e ndarjes së shpenzimeve përkufizojnë se cilat pjesë të shpenzimeve barten nga gjeneratorët të cilët kërkojnë lidhje dhe cilat pjesë nga operatorët e sistemeve të bartjes dhe shpërndarjes. Rregullat e ndarjes së shpenzimeve përkufizojnë se si do të ndahen shpenzimet e domosdoshme mes prodhuesve që më vonë kyçen në rrjet, në mënyrë që të gjithë të përfitojnë nga përforcimet apo linjat e reja.)

(c) Ju lutem të përshkruani se si i atribuohen prodhuesve dhe/apo operatorëve të sistemit të bartjes dhe shpërndarjes shpenzimet e kyçje dhe adaptimit teknik? Si janë në gjendje operatorët e sistemit të bartjes dhe shpërndarjes që të kthejnë këto investime? A planifikohet ndonjë modifikim i këtyre rregullave të bartjes së shpenzimeve në të ardhmen? *(ekzistojnë disa opsione sa i përket shpenzimeve të kyçje në rrjet të shpërndarjes. Palët kontraktuese ka të ngjarë të përzgjedhin ndonjërin nga këto opsione. Sipas shpenzimeve 'të thella' për kyçje, ndërtuesi i stabilimenteve për gjenerim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme bartë disa shpenzime që ndërlidhen me infrastrukturën e rrjetit (kyçjen në rrjet, përforcimin e rrjetit dhe zgjerimin e tij). Një qasje tjetër, qasjes së 'cekët' sa i përket ndarjes së shpenzimeve të kyçje, ndërtuesi bart vetëm shpenzimet e kyçje në rrjet por jo edhe përforcimin dhe zgjerimin e rrjetit (kjo përfshihet në tarifat e rrjetit dhe paguhet nga konsumatorët). Një variant tjetër është socializimi i të gjitha shpenzimeve të kyçje dhe mbulimi i tyre nga tarifat e rrjetit.)*

(d) Si do të sigurohet se operatorët e sistemit të bartjes dhe shpërndarjes do t'i ofrojnë prodhuesve të rinj mundësi për kyçje dhe informatat e domosdoshme sa i përket shpenzimeve, por edhe një orar të saktë mbi procedimin e kërkesave të tyre dhe një agjende indikative sa i përket kyçje së tyre në rrjet.

4.2.3. Operimi i rrjetit të elektroenergjetik (neni 16(2) dhe neni 16(7) dhe (8) i Direktivës 2009/28/EC)

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

(a) Si garantohet bartja dhe shpërndarja e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme nga operatorët e sistemeve të bartjes dhe shpërndarjes? A sigurohet qasje e garantuar apo me prioritet?

(b) Si sigurohet pra se kur operatorët e sistemit të bartjes dispeçojnë stabilimentet e prodhimit të energjisë elektrike i japin prioritet atyre që shfrytëzojnë burime të ripërtëritshme?

(c) A është i njoftuar autoriteti rregullativ i energjisë me këto masa? A ka ai kompetenca për të monitoruar dhe zbatuar këto masa?

(d) A janë të integruara në treg stabilimentet që prodhojnë energji elektrike nga burimet e ripërtëritshme? A mund të na sqaroni si? Cilat janë obligimet e tyre sa i përket pjesëmarrjes në treg të energjisë elektrike?

(e) Cilat janë rregullat e ngarkimit të tarifave të bartjes dhe shpërndarjes gjeneratorëve të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme?

4.3. Skemat përkrahëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme që aplikohen nga pala kontraktuese apo një grup i palëve kontraktuese

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

Skemat përkrahëse mund të jenë rregullative, mund të përcaktojnë caqe indikative dhe/apo obligime përkatëse. Ato mund të ofrojnë përkrahje financiare në investime apo në operim të një impianti. Gjithashtu, ekzistojnë masat e buta si fushatat informative, vetëdijësuese apo arsimore. Pasi që masat e buta përshkruhen më lartë, ky vlerësim do duhej të fokusohet në masat rregullative dhe financiare.

Ju lutemi t'i përshkruani skemat ekzistuese duke bërë reference ligjore, duke dhënë detaje mbi kohëzgjatjen e skemës (datën e fillimit dhe mbarimit), ndikimin në të kaluarën dhe shpjegimin e reformave apo skemave që planifikohen për të ardhmen dhe rezultatet e pritura të tyre?

Rregulloret

Rregulloret mund të përcaktojnë caqe dhe obligime indikative. Në rast se një obligim i tillë ekziston, ju lutemi të na ofroni detaje mbi këtë:

- (a) cila është baza ligjore e këtij obligimi/caku indikativ?
- (b) a ka ndonjë cak indikativ që bazohen në ndonjë teknologji specifike?
- (c) cilat janë obligimet/caqet indikative konkrete për secilin vit (sipas teknologjisë)?
- (d) kush duhet të plotësojë obligimin?
- (e) cilat janë pasojat e mospërbushjes?
- (f) a ekziston ndonjë mekanizëm për të mbikëqyrur përmbushjen?
- (g) a ekziston ndonjë mekanizëm për të modifikuar obligimet/caqet indikative?

Përkrahja financiare

Përkrahja financiare mund të klasifikohet në mënyra të ndryshme, si për shembull:

Përkrahja financiare për investime, grante kapitale, kredi me norma të ulëta të interesit, përjashtime apo zbritje tatimore, skema tenderimi, obligime lidhur me energjinë nga burimet e ripërtëritshme apo lidhur me certifikatat e verdha (certifikata të verdha që mund të tregtohen), tarifat feed-in, premitë feed-in dhe skemat vullnetare.

Për të gjitha skemat që i përdorni, ju lutemi të jepni ndonjë përshkrim të detajuar duke iu përgjigjur pyetjeve nëm vijim?

- (a) Si quhet skema dhe na ofroni një përshkrim të shkurtër të saj?
- (b) A është skema vullnetare apo obligative?
- (c) Kush menaxhon këtë skemë? (*organi implementues, autoriteti kontraktues*)
- (d) Cilat masa janë ndërmarrë për të siguruar disponueshmërinë e buxhetit/financave të domosdoshme për të arritur cakun indikativ kombëtar?
- (e) Si adresohet siguria dhe qëndrueshmëria afatgjatë përmes kësaj skeme?

(f) A rishikohet skema periodikisht? Çfarë mekanizma ekzistojnë për të grumbulluar informatat e kthyera dhe për të bërë përshtatje? Si është optimizuar kjo skemë deri tani?

(g) A dallon përkrahja nga teknologjia që shfrytëzohet?

(h) Cilat janë ndikimet e pritura sa i përket prodhimit të energjisë?

(i) A kushtëzohet përkrahja me arritjen e një cilësie të caktuar të efijencës energjetike?

(j) A ka ndonjë masë ekzistuese? A mund të na tregoni se cili akt legjislativ e rregullon atë?

(k) A ka ndonjë skemë të planifikuar? Kur do të mund të hynte në operim ajo?

(l) Cilat janë datat e fillimit dhe përfundimit (kohëzgjatja) e tërë kësaj skeme?

(m) A ka limitime maksimale apo minimale sa i përket sistemeve që mund të gëzojnë ndihmë?

(n) A është e mundshme që një projekt i caktuar të përkrahet nga më shumë se një masë? Cilat masa mund të kumuloohen?

(o) A ekzistojnë skema rajonale/lokale? Nëse po, ju lutemi shfrytëzoni të njëjtat kritere.

Pyetje specifike lidhur me përkrahjen financiare për investime:

(a) Çka ofrohet përmes skemës? (subvencione, grante kapitale, kredi me norma të ulëta amatore, zbritje apo shmangie tatimore, rikthim të taksave)

(b) Kush mund të përfitojë nga kjo skemë? A është ajo specifike për teknologji të caktuara?

(c) A pranohen dhe mundësohen kërkesa tërë kohën apo kjo bëhet në mënyrë periodike? Nëse bëhet në baza periodike, a mund të na e përshkruani frekuencën dhe kushtet e saj?

Kushtet specifike për tregti me certifikata:

(a) A ekziston ndonjë pjesë e energjisë së prodhuar elektrike që duhet të prodhohet nga burimet e ripërtëritshme?

(b) Kush e bartë atë obligim?

(c) A ekzistojnë linja specifike vetëm për një teknologji?

(d) Cilat teknologji mbulohen nga skema?

(e) A lejohet tregtimi ndërkombëtar i certifikatave? Cilat janë kushtet e kësaj?

(f) A ka çmim minimal të përcaktuar?

(g) A ka ndëshkim për mospërbushje?

(h) Cili është çmimi mesatar për certifikata? A bëhet ai publik? Ku?

(i) Cila është skema e tregimit të certifikatave?

(j) Sa gjatë mund të merr pjesë një impiant në skemë?

Pyetjet specifike për tarifën fikse feed-in:

(a) Cilat janë kushtet për të marrë tarifë fikse?

- (b) A ekziston ndonjë limitim i vëllimit total të energjisë elektrike të prodhuar në vit apo i kapaciteteve të instaluara që kanë të drejtë në tarifë?
- (c) A është e paraparë kjo skemë për një teknologji të caktuar? Cilat janë nivelet e tarifave për teknologji?
- (d) A ekzistojnë tarifa që bëjnë dallim sipas kritereve?
- (e) Për sa gjatë garantohet tarifa fikse?
- (f) A parasheh skema ndonjë përshtatje të tarifës?

Pyetje specifike për primet feed-in:

- (a) Cilat janë kushtet për të fituar primin?
- (b) A ka ndonjë limitim maksimal të vëllimit të energjisë së prodhuar apo kapaciteteve të instaluara që kanë të drejtë të fitojnë prim?
- (c) A jepet ajo si alternativë e tarifës fikse?
- (d) A është e paraparë kjo skemë për një teknologji të caktuar? Cilat janë nivelet e primeve për teknologji?
- (e) A ka ndonjë limitim minimal apo maksimal për primin? Ju lutem specifikoni.
- (f) Për sa gjatë garantohet çmimi i primit?
- (g) A parasheh skema ndonjë përshtatje të tarifës?

Pyetje specifike për tenderim:

- (a) Cila është frekuenca dhe madhësia e tenderëve?
- (b) Cilat teknologji specifikohen?
- (c) A janë të integruara ato me zhvillimin e rrjetit?

4.4. Skemat përkrahëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në ngrohje dhe ftohje që aplikohen nga pala kontraktuese apo një grup i palëve kontraktuese

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

Ju lutemi t'i përmbaheni strukturës së pikës 4.3 dhe ta aplikoni pyetjen ndaj masave përkrahëse për shfrytëzim të energjisë së ripërtëritshme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes. Ju lutemi të adresoni pikat vijuese shtesë:

- (a) Si i adaptohen skemat përkrahëse për energji elektrike nga burimet e ripërtëritshme për të adaptuar shfrytëzimin e CHP nga burimet e ripërtëritshme të energjisë?
- (b) Cilat skema përkrahëse inkurajojnë shfrytëzimin e ngrohjes dhe ftohjes qendrore duke shfrytëzuar burime të ripërtëritshme të energjisë?
- (d) Cilat skema përkrahëse inkurajojnë shfrytëzimin e ngrohjes dhe ftohjes qendrore nga burimet e ripërtëritshme të energjisë në stabilimente industriale?

4.5. Skemat përkrahëse për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme në transport që aplikohen nga pala kontraktuese apo një grup i palëve kontraktuese

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

Ju lutemi t'i përmbaheni strukturës së pikës 4.3 dhe ta aplikoni pyetjen ndaj masave përkrahëse për shfrytëzim të energjisë së ripërtëritshme në sektorin e transportit. Ju lutemi të bëni dallimet në bazë të modaliteteve të transportit (rrugor, jorugor). Ju lutemi adresoni pikat vijuese shitesë:

(a) Cilat janë obligimet konkrete/caqet indikative të vitit (për karburant apo për teknologji)?

(b) A ka dallim mes përkrahjes që ofrohet për lloje të ndryshme karburantesh apo për teknologji të ndryshme? A ka ndonjë përkrahje specifike për biokarburantë që plotësojnë kriteret e nenit 21(2) të Direktivës?

4.6. Masat specifike për promovimin e shfrytëzimit të energjisë nga biomasa

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

Biomasa luan një rol të rëndësishëm si energji primare në të gjithë sektorët: ngrohje dhe ftohje, energji elektrike dhe transport. Strategjitë kombëtare të biomasës janë kyçe për planifikimin e rolit dhe ndërveprimin mes energjive dhe ndërveprimin mes sektorë tjerë joenergjetik. Për këtë arsye, palët kontraktuese duhet të vlerësojnë potencialin e tyre vendor dhe të shtojnë mobilizimin në vend për prodhim të biomasës dhe për importim të saj. Ndikimi mbi sektorët tjerë joenergjetik dhe ndërveprimi me ta (si p.sh. industria e ushqimit, drurit dhe letrës, ndërtimtarisë, mobilieve, etj.) gjithashtu duhet analizuar.

4.6.1. Furnizimi me biomasë: prodhimi në vend dhe tregtimi

Në këtë pikë, palët kontraktues duhet të vlerësojnë furnizimin e biomasës në dispozicion në vend dhe nevojat e tyre për import.

Duhet bërë dallimi mes biomasës (A) nga pylltaria – furnizimi (1) direkt dhe (2) indirekt; (B) nga bujqësia dhe peshkataria – (1) produkte direkte dhe (2) dytësore/të përpunuara; dhe (C) nga mbeturinat – (1) mbeturinat e ngurta amvisërore që janë të degradueshme biologjikisht, (2) mbeturinat e ngurta industriale që janë të degradueshme biologjikisht, dhe (3) zgjura nga kanalizimi. Të dhënat kërkohet për nënkategoritë e para të lartpërmendura, ndërsa sa i përket informatave më të detajuara ato janë opsionale. Megjithatë, të dhënat e grumbulluara do të duhej të reflektonin kategorizimet në vijim dhe të përshtaten me njësitë në tabelën 7. Roli i importeve dhe eksporteve duhet të pasqyrohet.

Vëni re që copëzat, briketi dhe pelleti i drurit mund të jetë furnizim direkt apo indirekt nga pylltaria. Nëse informatat mbi pelletin përfshihen në tabelë do duhej specifikuar nëse lënda e parë merret drejtpërdrejt apo tërthorazi.

Në rastin e bogazit dhe biokarburantëve, sasia e lëndës së parë dhe jo e lëndës së përpunuar duhet paraqitur detajisht në tabelën 7. Nënkuptohet se për importe dhe eksporte sasia e lëndës së parë të biomasës për biokarburantë është më vështirë të vlerësohet dhe për këtë arsye duhen dhënë supozime. Përndryshe, nëse në tabelë vendosen vetëm informata në bazë të importeve, kjo duhet specifikuar në tabelë.

Tabela 7: furnizimi me biomasë në vitin (viti me të dhënat më të reja në dispozicion)

| Sektori i origjinës | | Sasia e burimeve vendore ²³ | Import | | Eksport BE/Jo-BE | Neto sasia | Prodhimi primar i energjisë |
|--|---|--|--------|-------|------------------|------------|-----------------------------|
| | | | BE | Jo-BE | | | |
| A) Biomasa nga pylltaria ²⁴ | Nga e cila: | | | | | | |
| | 1. Furnizim direkt i biomasës drusore nga pyjet dhe tokat pyjore për gjenerim të energjisë | | | | | | |
| | <i>Opsionale - nëse keni në dispozicion informata tjera mbi sasinë e stokut që bie në këtë kategori:</i> | | | | | | |
| | a) prerje b) mbetje nga prerjet (kurora, degë, trung, degëzime) c) mbetje nga menaxhimi i peizazhit (biomasë drusore nga parqet, kopshtet, shkurret) d) të tjera (ju lutemi t'i definoni) | | | | | | |
| | 2. Furnizimi indirekt i biomasës drusore për gjenerim të energjisë | | | | | | |
| | <i>Opsionale –nëse keni në dispozicion informata tjera më të detajuara mbi:</i> | | | | | | |
| | a) mbetjet nga prerjet me sharrë, zdruktaria, industria e mobilieve (pluhur druri dhe byk) b) produkte të industrisë së letrës (vaj dhe lëngje të zeza) c) dru të përpunuar – karburantë d) dru i ricikluar par përdorimit (ricikluar për gjenerim të energjisë, si mbetje e amvisërive) e) të tjera (ju lutemi definoni) | | | | | | |
| Biomasë nga peshkimi dhe bujqësia: | Nga e cila: | | | | | | |
| | 1. Produktet bujqësore dhe nga peshkataria që ofrohen direkt për gjenerim të energjisë | | | | | | |
| | <i>Opsionale – nëse keni në dispozicion informata më të detajuara mbi:</i> | | | | | | |
| | a) produktet e fushës (drithëra, fara për vaj, panxhar sheqeri, misër) b) plantacionet | | | | | | |

²³ Sasia e burimit në m3 (nëse është e mundshme, përndryshe të vendosen njësi tjera) për kategorinë A dhe nënkategoritë e saj, si dhe në tonë për kategoritë B dhe C dhe nënkategoritë e tyre.

²⁴ Biomasa nga pylltaria gjithashtu duhet të përfshijë biomasën nga industritë që bazohen në pylltari. Nën kategorinë e biomasës nga karburantët e përpunuar të ngurtë në pylltari, siç janë copëzat, pelleti dhe briketi, duhet përfshirë në nënkategorinë përkatëse të origjinës së tyre.

| | | | | | | | |
|---------------------------|---|--|--|--|--|--|--|
| | <p>c) drunjtë me rotacion të shkurtër</p> <p>c) bimë tjera energjetike (barëra)</p> <p>d) algat</p> <p>e) të tjera (ju lutem specifikoni)</p> | | | | | | |
| | <p>2. Produktet dytësore bujqësore dhe mbetjet e punuara dhe produktet dytësore të peshkimit për gjenerim të energjisë</p> | | | | | | |
| | <p><i>Opsional – nëse keni në dispozicion informata më të detajuara mbi:</i></p> <p>a) kashtën</p> <p>b) plehrat</p> <p>c) yndyrën shtazore</p> <p>d) ushqimet e mishit dhe ashtit</p> <p>e) produktet dytësore (siç janë farërat për vajra dhe vaji i ullirit)</p> <p>f) biomasa frutore (përfshirë guaskat, kokrrat)</p> <p>g) produktet dytësore nga peshkimi</p> <p>g) mbetjet nga verërat, ullinjtë, trungjet e pemëve</p> <p>h) të tjera (ju lutem specifikoni)</p> | | | | | | |
| C) Biomasa nga mbeturinat | Nga të cilat: | | | | | | |
| | <p>1. Pjesa e mbeturinave të ngurta amvisërore të degradueshme biologjikisht që përfshin biombeturina (mbeturina të degradueshme dhe nga parqet, mbeturina nga ushqimet dhe kuzhinat e amvisërive, restoranteve, uzinave dhe shitësve me pakicë, dhe mbeturinat e krahasueshme nga impiantet për përpunim të ushqimit) dhe gazra nga deponitë</p> | | | | | | |
| | <p>2. Pjesa e mbeturinave industriale të degradueshme biologjikisht (përfshirë letrën, kartonin, paletat)</p> | | | | | | |
| | <p>3. Zgjura nga kanalizimi</p> | | | | | | |

Ju lutemi të sqaroni faktorët e konvertimit/metodologjinë e kalkulimit që është përdorë më lartë për të konvertuar sasinë e burimeve në dispozicion në energji primare.

Ju lutemi specifikoni se në çfarë baze është kalkuluar pjesa e degradueshme biologjikisht e mbeturinave amvisërore dhe industriale.

Ju lutemi të shfrytëzoni tabelën 7a për të dhënë një supozim mbi shfrytëzimin e energjisë nga biomasa në vitet 2015 dhe 2020. (duke u bazuar në kategorizimin në tabelën 7)

Tabela 7a: Furnizimi i pritur me biomasë në vitet 2015 dhe 2020

| Sektori i origjinës | | 2015 | | 2020 | |
|--------------------------------------|--|-----------------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| | | Sasia e pritur e burimeve vendore | Prodhimi primar i energjisë (ktoe) | Sasia e pritur e burimeve vendore | Prodhimi primar i energjisë (ktoe) |
| A) Biomasë nga pylltaria | 1. Furnizim direkt i biomasës drusore nga pyjet dhe tokat pyjore për gjenerim të energjisë | | | | |
| | 2. Furnizimi indirekt i biomasës drusore për gjenerim të energjisë | | | | |
| B) Biomasë nga bujqësia dhe peshkimi | 1. Produktet bujqësore dhe nga peshkataria që ofrohen direkt për gjenerim të energjisë | | | | |
| | 2. Produktet dytësore bujqësore dhe mbetjet e punuara dhe produktet dytësore të peshkimit për gjenerim të energjisë | | | | |
| C) Biomasë nga mbeturinat | 1. 1. Pjesa e mbeturinave të ngurta amvisërore të degradueshme biologjikiht që përfshin biombeturina (mbeturina të degradueshme dhe nga parqet, mbeturina nga ushqimet dhe kuzhinat e amvisërive, restoranteve, uzinave dhe shitësve me pakicë, dhe mbeturinat e krahasueshme nga impiantet për përpunim të ushqimit) dhe gazra nga deponitë | | | | |
| | 2. Pjesa e mbeturinave industriale të degradueshme biologjikiht (përfshirë letrën, kartonin, paletat) | | | | |
| | 3. Zgjura nga kanalizimi | | | | |

Cili është roli i supozuar i biomasës së importuar deri në vitin 2020? Ju lutem të specifikoni sasi të e pritura (ktoe) dhe të tregoni se cilat janë shtetet e mundshme të importit.

Përveç informatave të dhëna më lartë, ju lutemi të përshkruani situatën aktuale sa i përket shfrytëzimit të tokës bujqësore të dedikuar për prodhim të energjisë, si në vijim:

Tabela 8: Shfrytëzimi aktual i tokës për prodhimin e kulturave që i dedikohen energjisë në vitin.... (viti për të cilin keni në dispozicion të dhëna)

| Shfrytëzimi i tokave bujqësore për prodhimin e kulturave që i dedikohen energjisë | Sipërfaqja (ha) |
|---|-----------------|
| 1) Toka e shfrytëzuar për drunj me rotacion të shpejtë (shelgjeve, plepave) | |
| 2) Toka e shfrytëzuar për kultura tjera energjetike, siç janë barërat (kallam, Miscanthus), sorghum | |

4.6.2. Masat për shtimin e disponueshmërisë së biomasës, duke marrë parasysh shfrytëzuesit tjerë të biomasës (sektorët e bujqësisë dhe pylltarisë)

Mobilizimi i burimeve të reja të biomasës:

- (a) Ju lutemi të specifikoni se sa është sipërfaqja e tokës së degraduar
- (b) Ju lutemi të specifikoni se sa është sipërfaqja e tokës së papunuar.
- (c) A janë propozuar masa për të inkurajuar shfrytëzimin e tokës së papunuar, tokës së degraduar etj. për qëllime të kultivimit e kulturave energjetike?
- (d) A planifikohet shfrytëzimi i materialeve primare të caktuara (siç është plehu i kafshëve) për shfrytëzim të energjisë?
- (e) A ekziston ndonjë politikë specifike për promovimin e prodhimit dhe shfrytëzimit të bogazit? Çfarë lloje të përdorimesh promovohen (lokal, ngrohje qendrore, rrjet i bogazit, integrim në rrjetin e gazit natyral)?
- (f) Cilat masa planifikohet të ndërmerren për të përmirësuar teknikat e menaxhimit pyjor në mënyrë që të maksimizohet nxjerrja e biomasës nga pyjet në mënyrë të qëndrueshme²⁵? Si do të përmirësohet menaxhimi i pyjeve, për të siguruar rritje në të ardhmen? Çfarë masash janë planifikuar për të maksimizuar nxjerrjen e biomasës ekzistuese që veç është në përdorim?

– **Ndikimi në sektorët tjerë:**

- (a) Si do të monitorohet ndikimi i shfrytëzimit të biomasës në energji në sektorët tjerë që bazohen në bujqësi dhe pylltari? Cilat janë këto ndikime? (nëse është e mundshme, ju lutemi të ofroni informata edhe mbi efektet kuantitative). A planifikohet monitorimi i këtyre ndikimeve në të ardhmen?
- (b) Çfarë lloje zhvillimesh priten në sektorë tjerë që bazohen në bujqësi dhe pylltari e që mund të kenë ndikim në përdorimin e energjisë? (p.sh. a do të mund të ndikojë efienca e shtuar/përmirësimi i produktivitetit në rritjen apo zbritjen e sasisë së produkteteve anësore në dispozicion për përdorim në energji?

5. Vlerësimet

(Raporti deri më 30 qershor 2011)

5.1. Vlerësim i potencialit për zhvillimin e burimeve vendore të energjisë së ripërtëritshme

Për tu përgatitur më mirë për implementimin e Direktivës 2009/28/EC, palët kontraktuese duhet të bëjnë një vlerësim të potencialit për zhvillim të burimeve vendore të energjisë së ripërtëritshme deri në qershor të vitit 2011. Tabela 10 me tabelat 1 dhe 3 të shabllonit të planeve kombëtare të veprimit për energji të ripërtëritshme, që janë miratuar sipas Direktivës 2009/28/EC, do të shfrytëzohen si kornizë për përmbledhjen e gjetjeve kryesore.

Sa i përket sektorit të energjisë elektrike, duhet të ofrohen të dhëna sa i përket kapacitetit të pritur (akumuluar) në MW e edhe sa i përket prodhimit vjetor (GWh), të

²⁵ Rekomandimet mund të gjenden në raportin e lëshuar nga Komisioni i Përhershëm për Pylltari II që punonte ad hoc në mobilizimin dhe shfrytëzimin efikas të drurit dhe materialeve drusore, duke iu përgjigjur mbetjeve të drurit. Ky raport mund të gjendet në wef-faqen http://ec.europa.eu/agriculture/fore/publi/sfc_wgii_final_report_072008_en.pdf

ndara sipas teknologjisë. Për burime të ujit, duhet bërë dallimi mes centraleve më të vogla se 1 MW, mes 1 dhe 10 MW dhe mbi 10 MW të kapacitetit të instaluar. Për energji solare, detajet duhet të jepen ndaras për pajisjet fotovoltaike dhe ndaras për energjinë solare të përqendruar. Të dhënat për energji nga era duhet të jepen edhe për zhvillimet në tokë edhe për ato në det. Për biomasë dallimi duhet bërë mes trajtave të ndryshme të ngurta, të lëngshme apo gazore dhe biomasës likuide për energji elektrike

